


10/04/2021

Shenjtori i ditës: Profetesha Olda - Hierodëshmor Grigori V, patriark i Konstandinopojës



E shtunë, 10 prill 2021 – Shenjtori i ditës.

JEMI NË KRESHMËN E MADHE TË PASHKËS

Profetesha Olda/Hulda. Dëshmorët Perikliu, Sofokliu, Miltiadhi, Demosten, Epaminonda etj. Hierodëshmor Grigori V, patriark i Konstandinopojës.

– Profetesha Olda –

Në mbretërimin e Josias, mbretit të Judës (640-609 para Krishtit), i cili ndërmori një reformë fetare dhe një kthim të nderimi i Perëndisë së vërtetë, Libri i Ligjit u rigjet në Tempullin e Jerusalemit. Kur dëgjoi fjalët që ai përmbante, mbreti shqeu rrobat dhe vajtoi duke thënë: “E madhe duhet të jetë zemërata e Zotit, që është ndezur kundër nesh, sepse etërit tanë nuk u janë bindur fjalëve të këtij libri” (IV Mbret. 22:14). Ai dërgoi priftërinj te profeteshë Hulda, gruaja e Shallumit, që banonte në Jerusalemit. Nën frymëzimin e Perëndisë, ajo ripohoi zemërimin e Perëndisë kundër Jerusalemit të pabesë, por i tha mbretit Josia këto fjalë: “Kështu flet Zoti, Perëndia i Izraelit, meqë zemra jote është prekur dhe ti je përulur para Zotit, Perëndisë së Izraelit, kur dëgjove vendimin që unë shqiptova kundër këtij vendi dhe banorëve të tij, që do të bëhen objekt tmerrri dhe mallkimi, dhe meqë ti ke grisur rrobat e tua dhe ke vajtuar përpara meje, unë të kam dëgjuar. Prandaj unë do të të bashkoj me etërit e tu; ti do të pritesh në paqe në varrin tënd, sytë e tu nuk do të shikojnë të gjitha fatkeqësitë që do të bëj të vijnë mbi këtë vend”. Me të vërtetë, ndodhi që pas vdekjes së këtij mbreti të drejtë, filluan shumë fatkeqësi, të cilat çuan në rrënimin e Jerusalemit dhe internimin e popullit në Babiloni (609-587). Sa për profeteshën Hulda, Shkrimi i Shenjtë nuk jep detaje të tjera të jetës së saj.

– Hierodëshmor Grigori V, patriark i Konstandinopojës –

Shën Grigori lindi në vitin 1745, në gjirin e në familjeje të varfër nga Dhimicani, në Peloponez. Mbaroi shkollën fillore pranë të ungjit, që ishte hieromonak, pastaj shkoi e u vendos në Smirni. U bë murg në manastirin e Strofadhës dhe plotësoi studimet teologjike në Patmos. Kur u kthye në Smirni, mitropoliti Prokop, që ushqente dashuri atërore ndaj tij, e bëri kryedhjakon, më pas e hirotonisi prift dhe kur u bë patriark (1788), e caktoi Grigorin pasues të tij.

Për dymbëdhjetë vjet, hierarku i shenjtë e qeverisi me urtësi dhe zell apostolik qytetin e madh dhe të pasur të Smirnit, qendër shumë e rëndësishme e Orthodhoksisë në Azinë e Vogël. Ndërtoi shumë kisha, themeloi shkolla dhe organizoi sistemin e bamirësisë për të varfrit. Në vitin 1797, u zgjodh patriark ekumenik dhe filloi menjëherë ringritjen e pallatit të Fanarit. Ai themeloi edhe një shtypshkronjë, në të cilën botonte libra në gjuhën e popullit, të cilët kontribuan jashtë mase në zgjimin shpirtëror dhe kulturor të popullit të krishterë. Hierarku i shenjtë vigjilonte për ruajtjen dhe zbatimin e rreptë të kanoneve të shenjta dhe për palëkundshmërinë morale të klerit. Në ato kohë të turbullta, kur populli i krishterë

vuante nën zgjedhën otomane prej katër shekujsh, u brumos lëvizja për një kryengritje të përgjithshme kundër pushtuesve. I ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tij si bari, patriarku përpigëj të moderonte shpirtrat e trazuar, duke forcuar fshehurazi ndjenjën çlirimtare në gjirin e popullit.

Pas një viti e gjysmë, u denoncua te sulltani nga episkopë, të cilët i kishte qortuar për sjelljet e tyre. E internuan në Halkidonë dhe më pas në manastirin e Ivronit, në Malin e Shenjtë. Gjatë qëndrimit të tij të detyruar në Malin Athos, shenjtori vizitoi të gjitha manastiret, përhapi fjalën e Perëndisë dhe u bë për të gjithë model i jetës murgërore. Ai i dha bekimin shën Efthimit (22 mars), për t'u martirizuar dhe shprehu gëzimin e krenarinë për lajmin e martirizimit të shën Agathangjelit (19 prill). Me këtë tregoi se e shikonte vdekjen për hir të dashurisë së Perëndisë, si qëllimin më të lartë dhe kurorëzimin e jetës së krishterë.

I rithirrur në Patriarkanë në vitin 1806, u pranua me entuziazëm të madh nga populli i krishterë i Konstandinopojës. Rifilloi me guxim të madh punën baritore dhe korrigjimin e zakoneve e sjelljeve kishtare. Por, në vitin 1808, një grusht shteti solli në pushtet sulltanin Mehmeti II, që e detyroi të dorëhiqej përsëri dhe të shkonte në ishullin e Prinkipos. Pastaj shkoi sërish në Malin e Shenjtë, ku rifilloi studimet e tij patristike dhe ushtrimet asketike. Ai ishte i mirinformuar për gjendjen e Kishës dhe të popullit.

Në vitin 1818, u afrua nga anëtarë të Shoqërisë së Miqve, shoqëri sekrete që po përgatiste kryengritjen, duke u përpjekur të bashkonin fuqitë e shpërndara. Grigori, e shfaqti në mënyrë entuziaste mbështetjen për kauzën e lirisë, por, duke gjykuar se nuk kishte ardhur ende koha për të qenë diçka e pjekur, i këshilloi të tregonin durim. Pak kohë më vonë, u thirr për herë të tretë për të drejtuar fronin patriarkal, duke nxitur në mënyrë të veçantë themelimin e shkollave, ku nxënësit mund të merrnin një formim të krishterë dhe tradicional. Ai ngriti edhe një arkë ndihmesh, ku grekët e pasur kontribuonin për të ndihmuar të krishterët që vuanin.

Kur nisi Kryengritja Greke e principatave të Danubit, në zonën e Moldavisë (1 shkurt 1821), e karakterizuar nga mungesa e plotë e organizimit, në Konstandinopojë nisën raprezalje të tmerrshme dhe të përgjakshme, gjë që u përhap edhe në qendrat më të mëdha të Perandorisë Otomane. U masakruan të gjithë personat e rëndësishëm, që kishin lidhje me këtë kryengritje dhe u arrestuan katër episkopë. Kur qeveria dha urdhër të mbledheshin në Fanar familjet e parisë greke të Konstandinopojës, patriarku, për të evituar masakrën, doli garant te Porta e Lartë për besnikërinë e tyre. I pakënaqur për këtë deklaratë, sulltani e detyroi shën Grigorin të nënshkruante aforizimin e kreut të kryengritjes, Aleksandër Ipsilantit dhe të shokëve të tij.

Më 31 mars, shpërtheu kryengritja e përgjithshme në Peloponez dhe tri ditë më vonë, të Hënën e Madhe, Dragomani i madh, që përfaqësonte komunitetin grek pranë oborrit të sulltanit, u ekzekutua bashkë me arkondë të tjerë. Shenjtori parashikoi se ky do të ishte fati i tij dhe prandaj refuzoi propozimet për t'u larguar, duke thënë: "Si mund të braktis grigjën time? Jam patriarku i tyre për ta shpëtuar grigjën dhe jo për ta lënë nën mëshirën e shpatës së jeniçerëve. Vdekja ime do të jetë më e dobishme sesa jeta ime, sepse të krishterët do të luftojnë të frymëzuar prej saj me energjinë e dëshpërimit, që shpesh sjell fitoren. Jo, nuk do të bëhem gazi i botës duke u arratisur, që të më tregojnë me gisht, duke thënë: 'Ja patriarku vrasës!'".

Ditën e Pashkës, më 10 prill, shën Grigori kremtoi me qetësi të madhe dhe madhështi Liturgjinë e Ngjalljes, që ndërpritej vetëm nga ngashërimat. Në mbarim të shërbesës, i konfirmuan lajmin e kryengritjes së Peloponezit. Atëherë ai tha: "U bëftë tani e përgjithmonë vullneti i Zotit". Pak orë më vonë i bënë të ditur largimin e tij nga froni patriarkal dhe jeniçerët e burgosën, pa shumë ceremoni. E morën në pyetje dhe e torturuan, por ai ruajti një heshtje madhështore. Kur i thanë se do të shpëtonte po të mohonte Krishtin, u tha: "Patriarku i të krishterëve, duhet të vdesë i krishterë!". Pak kohë pas zgjedhjes së pasuesit të tij nga anëtarët e Sinodit të Shenjtë, e varën në derën e Patriarkanës. Që nga ajo kohë, kjo derë ka mbetur e mbyllur, në kujtim të kësaj ngjarjeje mizore. Në çastin e fundit, Patriarku ngriti duart drejt qiellit, bekoi të krishterët e pranishëm dhe tha: "Zot Jisu Krisht, pranoje shpirtin tim!". Ndërsa turqit dhe judenjtë gjuanin me gurë kufomën e patriarkut, veziri që ishte ngarkuar me ekzekutimin e tij, qëndronte i ulur përpara trupit, duke pirë duhan.

Trupin e patriarkut të shenjtë e lanë të varur për tri ditë, me vendimin e dënimit të varur në qafë. Në fund, judenjtë e blenë trupin për 800 piastra dhe e tërhoqën nëpër rrugë, në mes të thirrjeve të tyre triumfuese, pastaj e hodhën në det. Edhe

pse i varën një gur të rëndë në qafë, trupi arriti të dilte mbi ujë dhe u gjet nga një anije greke nën flamurin rus, që e çoi në Odesë. Atje, lipsani i tij, që nuk tregoi shenja dekompozimi, u nderua gjatë tri ditëve nga populli i krishterë.

Në vitin 1871, me rastin e pesëdhjetëvjetorit të Revolucionit Grek, trupi i patriarkut të shenjtë u transferua në Athinë dhe u vendos me nderime të mëdha në kishën metropolitane.

